REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3541 prot.

**Qafë-Mali, më 10.11.2025**

# PROCESVERBAL

**TEMA: KONSULTIM PUBLIK** PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QIRA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME NË TERRITORIN E NJËSISË ADMINISTRATIVE **QAFË-MALI,** BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 18 pika 1, pika 2, neni 54 germa (dh), germa (f) dhe në Rregulloren për Funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz (VKB Nr. 15, datë 27.04.2020) Neni 153, Neni 154, **u mbajt sot, më 10.11.2025, në ambientet e Njësisë Administrative Qafë-Mali, Ora:12:00, Dëgjesa publike mbi projektvendimin** "Për dhënie në përdorim/qira Fondit Pyjor për Energji të Rinovueshme në territorin e Njësisë Administrative **Qafë-Mali,** Bashkia Fushë-Arrëz".

**Në takim morën pjesë nga NjVQV:**

1. Kryetar i Bashkisë, **Z. Hil Curri**
2. Zëvendëskryetar i Bashkisë, **Z. Mikel Qafa**
3. Sekretar për Këshillin Bashkiak, **Znj. Naze Selimaj**
4. Përgjegjëse e Zyrës së Auditit, **Entela Pepa**
5. Përgjegjës për Zyrën e Emergjencave Civile, **Z Dod Pepa**
6. Përgjegjës për Policinë Bashkiake, **Z. Nikolin Qafa**
7. Specialiste IT në Bashki, **Albina Prenga**

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjesë publike janë **banorët e Njësisë Administrative Qafë-Mali si dhe të fshatrave Kryezi, Qafë-Mali, Orosh, Lumbardh, Lajthizë, Tuç si dhe kryetarë të fshatrave.**




*Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz* *email: info@bashkiafushearrez.gov.al*

Fjalën hapëse e mbajti Administratori i Njësisë Administrative **Z. Mirash Mardodaj**



Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe në veçanti Kryetarin e Bashkisë Fushë-Arrëz, z. Hil Curri për dëgjesën publike të organizuar me banorët e Njësisë Administrative Qafë-Mali. Administratori i Njësisë Administrative Z. Mirash Mardodaj e konsideron dëgjesën shumë të rëndësishme për informinin dhe njohjen e banorëve me çdo planifikim përmes projekteve në kuadër të zhvillimit të zonës së Njësisë Administrative Qafë-Mali.

Z. Mardodaj u shpreh se nuk do të ndalojmë në zhvillimin e zonës përmes projekteve gjithmonë në bashkëpunim dhe dakordësi me banorët e zonës së Njësisë Administrative Qafë-Mali dhe kjo falë mbështetjes e bashkëpunimit me Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Kryetarin Z. Hil Curri.

Në vijim fjalën e merr **Kryetari i Bashkisë, Z. Hil Curri:**



Faleminderit dhe mirë së keni ardhë në këtë dëgjesë konsultative ku pjesëmarrja juaj tregon se interesi qytetar dhe padyshim besimi ndaj pushtetit vendor po vjen duke u rritur. Dëgjesat publike si kjo janë jo vetëm detyrim ligjor por dhe të rëndësishme për një qeverisje pranë qytetarëve. Jemi këtu për të dëgjuar zërin tuaj lidhur me projektvendimin për dhënie në përdorim/qira Fondit Pyjor për Energji të Rinovueshme në territorin e Njësisë Administrative Qafë-Mali, Bashkia Fushë-Arrëz.

Shumë e rëndësishme të marrësh vendime të cilat e zhvillojnë zonën, kjo kërkon forcë e këmbëngulje, një pjesë e madhe janë pro dhe një pakicë mund të jenë kundra.

Jemi në bisedime me biznesmenë dhe emigrantët dhe ju bëj me dije se do të kemi investime të shumta. Besoj në mbulimin energjetik të zonës me panele Diellore.

Ne kemi në dispozicion linja bashkëpunimi për çdo lloj investimi në fushën e energjetikës, veçanërisht për projektet me panele diellore, të cilat mund të sjellin përfitime të drejtpërdrejta për komunitetin. Është detyrë e jona të konsultohemi me ju për çdo investim që lidhet me zhvillimin e zonës, sepse vendimmarrja duhet të jetë e përbashkët dhe transparente.

Dëshira ime është të nxisim investime në të gjitha njësitë administrative, pa përjashtim. Aktualisht, kompani të ndryshme po shfaqin interes dhe po lobojnë për të sjellë projekte të rëndësishme në fushën e energjisë së rinovueshme. Prandaj, dua t'ju pyes drejtpërdrejt: A doni ju si banorë investime që sjellin zhvillim për zonën tuaj?

Ne jemi të gatshëm të avancojmë dhe të hapim mundësi të reja, përfshirë investimet në energjinë diellore dhe përdorimin me qira të fondit pyjor, gjithmonë duke siguruar që çdo hap të jetë në të mirë të komunitetit. Së bashku mund të ndërtojmë një model zhvillimi modern, të qëndrueshëm dhe me përfitime afatgjata për të gjithë.

**Agim Pashkaj,** Kryetar i fshatit Lajthizë:



Përshëndetje të gjithëve! Faleminderit që na keni mbledhur!

Unë vetë me pronarin e fabrikës së Lajthizës kemi vendosë themelet e asaj fabrike të ujit që gjendet tashmë në fshatin tonë duke rënë dakord menjëherë sepse ishte një mirësi për zhvillimin e zonës. Dua të them se investimet janë me shumë vlera për zonat tona. Jemi për zhvillim përmes investimeve.

**Gjovalin Bardhoku,** Kryetar i fshatit Qafë-Mali:



Punësimi është në nivelin më të lartë sepse kemi gjithë këto fabrika në zonën tone. Investimet mendojmë të lejohen, janë në të mirë të komunitetit.



**Mikel Qafa,** Zëvendëskryertar i bashkisë: Përshëndetje të gjithëve! Faleminderit që jeni sot këtu në këtë bashkëbisedim lidhur me projektin "Për dhënie në përdorim/qira Fondit Pyjor për Energji të Rinovueshme në territorin e Njësisë Administrative Qafë-Mali, Bashkia Fushë-Arrëz". Sa më shumë investime, aq më mirë për komunitetin

**Ndrek Çukaj,** Kryetar i fshatit Kryezi:



Sa i përket investitorëve të huaj nuk jam dakord, duam të investojmë vetë, mbase njerëzit kthehen në vendet e tyre.







***Bashkëlidhur këtij procesverbali, gjendet lista e pjesëmarrësve në këtë dëgjesë publike.***

**SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKIAK**

**Naze SELIMAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Qafë-Mali, më 10.11.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI I BASHKISË

# LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QERA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME ( EOLIKE)

| Nr. | Emër Mbiemër | Njësia/Qyteti/Fshati | Pozicioni/Profesioni | Firma |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Dad Pepa | Qafe-Mali | Ing. Pyjesh | [signature] |
| 2. | Entela Pepa | Qafë-Mali | Juriste | [signature] |
| 3. | Shqipe Arifaj | Qafe-Mali | Arkiv-Prot. | [signature] |
| 4. | Xhuana Gjonaj | Qafe-Mali | | [signature] |
| 5. | Emuel Mardodaj | Qafe-Mali | | [signature] |
| 6. | Davë Bibaj | Qafe-Mali | | [signature] |
| 7. | Ndrek Gulaj | Qaf-Mali | Kryetar fshati | [signature] |
| 8. | Zef Ndoci | | | [signature] |
| 9. | Sokol Aliu | | | [signature] |
| 10. | Rrok Mardodaj | | | [signature] |
| 11. | Dede Saluri | | | [signature] |
| 12. | Pal Mardodaj | | | [signature] |
| 13. | Anton [illegible] | | | [signature] |

Qafë-Mali, më 10.11.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI I BASHKISË

## LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QERA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME ( EOLIKE)

| Nr. | Emër Mbiemër | Njësia/Qyteti/Fshati | Pozicioni/Profesioni | Firma |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Pashuk Bilaj | Qaf mali | Oroshë | [signature] |
| 2. | Gjergj Bardhoku | Qaf-Ma | Bekolli | Qaf. Mali [signature] |
| 3. | DORONTI | VASARHELYI | | [signature] |
| 4. | Gjergj Dedaj | Bordhet | | [signature] |
| 5. | Anton Pjetri | Bordhet | | [signature] |
| 6. | MIRASH MARDODAJ | | | [signature] |
| 7. | Naze Selimaj | Fushë-Arrëz | Sekretare KB | [signature] |
| 8. | Albina Prenga | Fushë-Arrëz | Specialiste IT | [signature] |
| 9. | Hil Curri | Bashkia | Kryetar i Bashkisë | [signature] |
| 10. | | | | |
| 11. | | | | |
| 12. | | | | |
| 13. | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3583 prot. **Fierzë, më 12.11.2025**

## PROCESVERBAL

**TEMA: KONSULTIM PUBLIK** PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QIRA FONDIT PYJOR PËR **ENERGJI TË RINOVUESHME** NË TERRITORIN E NJËSISË ADMINISTRATIVE **FIERZË,** BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 18 pika 1, pika 2, neni 54 germa (dh), germa (f) dhe në Rregulloren për Funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz (VKB Nr. 15, datë 27.04.2020) Neni 153, Neni 154, **u mbajt sot, më 12.11.2025, në ambientet e Njësisë Administrative Fierzë, Ora:12:00, Dëgjesa publike mbi projektvendimin** "Për dhënie në përdorim/qira Fondit Pyjor për Energji të Rinovueshme në territorin e Njësisë Administrative **Fierzë,** Bashkia Fushë-Arrëz".

**Në takim morën pjesë nga NjVQV:**

1. Kryetar i Bashkisë, **Z. Hil Curri**
2. Zëvendëskryetar i Bashkisë, **Z. Mikel Qafa**
3. Sekretar për Këshillin Bashkiak, **Znj. Naze Selimaj**
4. Drejtor për Zyrën e Burimeve Njerëzore, **Znj. Fationa Selimaj**
5. Përgjegjës për Policinë Bashkiake, **Z. Nikolin Qafa**
6. Punonjëse e Policisë Bashkiake, **Znj. Violeta Vuka**
7. Anëtar i Këshillit Bashkiak, **Z. Nikolin Sadiku**

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjesë publike janë **banorët e Njësisë Administrative Fierzë, të fshatrave Kokdodë, Mëzi, Fierzë, Arst, Miliska, Porav, Bugjon, Aprripe si dhe kryetarë të fshatrave.**



*Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz* *email: info@bashkiafushearrez.gov.al*

**Fjalën hapëse e mbajti Administratori i Njësisë Administrative Z. Ylber Sokoli**



Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe në veçanti Kryetarin e Bashkisë Fushë-Arrëz, z. Hil Curri për dëgjesat publike të organizuara me banorët e zonës, i vetmi Kryetar qysh në vitin 1990 që organizon takime të tilla të hapura!

Administratori i Njësisë Administrative Z. Ylber Sokoli e konsideron dëgjesën shumë të rëndësishme për informinin dhe njohjen e banorëve me çdo planifikim përmes projekteve në kuadër të zhvillimit të zonës së Njësisë Administrative Fierzë.

Z. Sokoli u shpreh se nuk do të ndalojmë në zhvillimin e zonës përmes projekteve gjithmonë në bashkëpunim dhe dakordësi me banorët e zonës së Njësisë Administrative Fierzë dhe kjo falë mbështetjes e bashkëpunimit me Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Kryetarin Z. Hil Curri.

Në vijim fjalën e merr **Kryetari i Bashkisë, Z. Hil Curri:**



Faleminderit dhe mirë së keni ardhë në këtë dëgjesë konsultative ku pjesëmarrja juaj tregon se interesi qytetar dhe padyshim besimi ndaj pushtetit vendor po vjen duke u rritur. Dëgjesat publike si kjo janë jo vetëm detyrim ligjor por dhe të rëndësishme për një qeverisje pranë qytetarëve. Jemi këtu për të dëgjuar zërin tuaj lidhur me projektvendimin për dhënie në përdorim/qira Fondit Pyjor për Energji të Rinovueshme në territorin e Njësisë Administrative **Fierzë,** Bashkia Fushë-Arrëz.

Dëshira ime të bëj investime në të gjitha Njësitë. Ne kemi linja të çdo lloj investimi në fushën e energjetikës.

Shumë e rëndësishme të marrësh vendime të cilat e zhvillojnë zonën, kjo kërkon forcë e këmbëngulje, një pjesë e madhe janë pro dhe një pakicë mund të jenë kundra.

Jemi në bisedime me biznesmenë dhe emigrantët dhe ju bëj me dije se do të kemi investime të shumta. Besoj në mbulimin energjetik të zonës me panele Diellore.

Investimet në energji të rinovueshme sjellin:

Të ardhura për familjet përmes shitjes së energjisë

Krijim të vendeve të punës në instalim, mirëmbajtje dhe shërbime teknike.

Zhvillim të infrastrukturës (rrugë, rrjete elektrike).

Nuk kam bërë dhe nuk do të bëj asnjë hap pas duke biseduar dhe bashkëpunuar me të gjithë faktorët politik dhe jopolitik, me të gjitha fondacionet, Ambasadat në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve si dhe zhvillimin afatgjatë të territorit të bashkisë tone.

Faleminderit që më dëgjuat dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj, do t'ju dëgjoj me vëmendje dhe do të shënojmë çdo kërkesë dhe nevojë tuajën për shërbime dhe investime.

**Pëllumb Shpendi**, banor i fshatit Aprripë:

Ne si banorë të fshatit Aprripë, jemi dakord me çdo projekt që si rezultat ka zhvillimin e zonës dhe mirëqenien e banorëve.



**Kryetari i Bashkisë Z. Hil Curri:**

Ne po lobojmë fort me kompani të ndryshme për këtë projekt i cili është tejet fitimprurës . Do të bëjmë plantacione me panele diellore dhe jo vetëm. Panelet janë zhvillim për vendin

**Palush Gjoni, Kryetar i fshatit Fierzë:**

Falenderoj Kryetarin e Bashkisë Z. Hil Curri si dhe Administratorin e Njësisë Administrative Z.Ylber Sokoli për për bashkërendimin e organizimit lidhur me këtë dëgjesë publike.



Resurset që kemi duhet të shfrytëzohen. Jemi dakord të investohet në zonën tonë por pa prek pronat tona. As edhe një bujtinë nuk gjendet në Njësinë tonë.





**Hil Curri, Kryetar i Bashkisë:** Unë ju falenderoj për prezencën dhe bashkëpunumin tuaj!

Unë nuk do të resht për të gjetur çdo mundësi e projekt që e zhvillon zonën dhe rrit mirëqenien e banorëve të zonës. Do të jemi transparent në çdo hap që do të ndërmerret lidhur me projekte të tilla të cilat nuk cënojnë pronën e askujt.



Në përgjithësi, banorët janë pro projekteve që zhvillojnë zonën.

***Bashkëlidhur këtij procesverbali, gjendet lista e pjesëmarrësve në këtë dëgjesë publike.***

**SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKIAK**

**Naze SELIMAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Fierzë, më 12 . 11 .2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**
**KËSHILLI I BASHKISË**

**LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QERA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME ( EOLIKE), NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË, BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

| Nr. | Emër Mbiemër | Njësia/Qyteti/Fshati | Pozicioni/Profesioni | Firma |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Ylber Sokoli | | | |
| 2. | Bonim Beqo | | | |
| 3. | SOKOL IBRAJ | | | |
| 4. | Gjovalin Stoke | | | |
| 5. | Dorjan Gerini | | | |
| 6. | [illegible] Kruja | | | |
| 7. | Fatmir Hysaj | | | |
| 8. | Hil Miceli | | | |
| 9. | Duam Sadria | | | |
| 10. | Elidon Mogjuni | | | |
| 11. | Palush Gjoka | | | |
| 12. | Kol Shpendi | | | |
| 13. | Ded Elezi | | | |
| 14. | Gjok [illegible] | | | |

Fierzë, më 12 . 11 .2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE "PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QERA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME (EOLIKE), NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË, BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

| Nr. | Emër Mbiemër | Njësia/Qyteti/Fshati | Pozicioni/Profesioni | Firma |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Mhill Kola | | | |
| 2. | Nikolin Sediku | | | |
| 3. | Gjelosh Ukdo | | | |
| 4. | Pal | Miceli | | |
| 5. | Naze Selimaj | Fushë-Arrëz | Sekretare e KB | |
| 6. | Nicolin Gaga | Fushë-Arrëz | | |
| 7. | Violeta Vukaj | Fushë-Arrëz | | |
| 8. | Fationa Selimaj | Fushë-Arrëz | Drejtoresh e Burimeve Njerëzore | |
| 9. | Hil Curri | Bashkia F-Arrëz | Kryetar Bashkie | |
| 10. | Mikel Qafa | B. Fushë-Arrëz | Zv. Kryetar | |
| 11. | | | | |
| 12. | | | | |
| 13. | | | | |
| 14. | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3751 prot. Blerim, më 26.11.2025

**PROCESVERBAL**

**TEMA: KONSULTIM PUBLIK** PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QIRA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME NË TERRITORIN E NJËSISË ADMINISTRATIVE **BLERIM,** BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 18 pika 1, pika 2, neni 54 germa (dh), germa (f) dhe në Rregulloren për Funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz (VKB Nr. 15, datë 27.04.2020) Neni 153, Neni 154, **u mbajt sot, më 26.11.2025, në ambientet e Njësisë Administrative Blerim, Ora:12:00, dëgjesa publike mbi projektvendimin** "Për dhënie në përdorim/qira Fondit Pyjor për Energji të Rinovueshme në territorin e Njësisë Administrative Blerim, Bashkia Fushë-Arrëz".

**Në takim morën pjesë nga NJVQV:**

1. Zëvendëskryetar i Bashkisë, **Z. Mikel Qafa**
2. Drejtor për Zyrën e Urbanistikës, **Z. Tonin Prenga**
3. Drejtor për Shërbimet Publike, **Z Pashk Prendi**
4. Sekretar për Këshillin Bashkiak, **Znj. Naze Selimaj**

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjesë publike janë **banorët e Njësisë Administrative Blerim, banorë të fshatrave Dardhë, Qebik, Truen, Blerim, Kulumri, Xath si dhe kryetarë të fshatrave.**



Fjalën hapëse e mbajti Administratori i Njësisë Administrative Blerim **Z. Gjovalin Prendi**



Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen në këtë dëgjesë publike të organizuar me banorët e Njësisë Administrative Blerim. Administratori i Njësisë Administrative Blerim Z. Gjovalin Prendi e konsideron dëgjesën shumë të rëndësishme për informinin dhe njohjen e banorëve me çdo planifikim përmes projekteve në kuadër të zhvillimit të zonës së Njësisë Administrative Blerim.

Z.Prendi u shpreh se nuk do të ndalojmë në zhvillimin e zonës përmes projekteve gjithmonë në bashkëpunim dhe dakordësi me banorët e zonës së Njësisë Administrative Blerim.



Në vijim fjalën e merr Zëvendëskryetar i Bashkisë, **Z. Mikel Qafa:** Të nderuar qytetarë, përfaqësues të komunitetit, institucioneve dhe të interesuar,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultimi publik, i cili organizohet në kuadër të transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Qëllimi i këtij takimi është prezantimi dhe diskutimi i projekvendimit "Për dhënie në përdorim/qira të fondit pyjor për energji të rinovueshme në territorin e Njësisë Administrative Blerim, Bashkia Fushë-Arrëz", si dhe mbledhja e mendimeve, sugjerimeve dhe shqetësimeve tuaja lidhur me këtë nismë.

Ky projekvendim synon të krijojë mundësi për shfrytëzimin e qëndrueshëm të fondit pyjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke kontribuar në zhvillimin e energjisë së rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik lokal. Energjia e rinovueshme përfaqëson një prioritet strategjik, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe për bashkinë tonë, si një mënyrë për të nxitur investime të reja, punësim dhe përdorim racional të burimeve natyrore.

Theksojmë se çdo vendimmarrje do të bëhet duke respektuar: - mbrojtjen e ekosistemit pyjor dhe biodiversitetit, - interesin e komunitetit lokal, - transparencën dhe ligjshmërinë e procedurave, si dhe balancën midis zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së mjedisit.

Ky konsultim publik është një hap i rëndësishëm për të garantuar që zëri i qytetarëve të dëgjohet dhe të merret në konsideratë përpara miratimit përfundimtar të projekvendimit nga Këshilli Bashkiak.

Ju ftoj të shprehni lirshëm mendimet, pyetjet dhe propozimet tuaja, të cilat do të dokumentohen dhe do të jenë pjesë e procesit të vlerësimit të mëtejshëm.

Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe angazhimin tuaj në ndërtimin e një zhvillimi të qëndrueshëm për Njësinë Administrative Blerim dhe për Bashkinë Fushë-Arrëz në tërësi.

Jemi në bisedime me biznesmenë dhe emigrantët dhe ju bëj me dije se do të kemi investime të shumta. Besojmë në mbulimin energjetik të zonës me Panele diellore.

**Tonin Prenga**, Drejtor i Zyrës së Urbanistikës:

Mundësia më e mirë për zhvillimin e zonës është ajo private.

Dy projekte kanë qenë planifiku në fshatin Flet, një hidrocentral dhe një fabrikë uji, që të dyja janë kthyer mbrapsht me mosdakordësinë tuaj. Investimet private zhvillojnë zonën dhe janë mundësi punësimi. Ju lutemi të jeni më dashamirës me biznesin privat, bashkëpunoni me investitorët për zhvillimin e zonës. Një ndër mundësitë më të mira është ajo e Paneleve diellore tani.

**Gjovalin Prendi**, Administratori i Njësisë Administrative Blerim: Jemi për investime nga ana e biznesit privat, por gjithmonë me dakordësinë e banorëve.

**Qazim Baftia**, Kryetar i fshatit Flet:

Unë si kryetar fshati nuk lëshoj asnjë vulë për asnjë lloj biznesi pa dakordësinë e banorëve të fshatit Flet.





***Bashkëlidhur këtij procesverbali, gjendet lista e pjesëmarrësve në këtë dëgjesë publike.***

**SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKIAK**

**Naze SELIMAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Blerim, më 26 . 11 .2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE "PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QERA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME (EOLIKE), NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM, BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

| Nr. | Emër Mbiemër | Njësia/Qyteti/Fshati | Pozicioni/Profesioni | Firma |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Tom Syla | Qebik | | [signature] |
| 2. | Alspard Syla | Qebik | | [signature] |
| 3. | Albin Syla | DARDH | | [signature] |
| 4. | AGRON SYLA | DARDH | | [signature] |
| 5. | Azim Zmolaj | XATH | | [signature] |
| 6. | Rozim Bisotijor | | | [signature] |
| 7. | Xhelodin Zmolaj | XATH | | [signature] |
| 8. | Altin Zmaloj Xath | | | [signature] |
| 9. | Parbla Orend | Qebik | | [signature] |
| 10. | Fadil Velaj | Xoth. | | [signature] |
| 11. | ERMIR XHAUKI | FIET | | [signature] |
| 12. | Adriatik Pajo | Trem. | | [signature] |
| 13. | Elez Poja | Trum. | | [signature] |
| 14. | Zef Zefi | Qebik | | [signature] |

Blerim, më 26 . 11 .2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

**LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QERA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME ( EOLIKE), NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM, BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

| Nr. | Emër Mbiemër | Njësia/Qyteti/Fshati | Pozicioni/Profesioni | Firma |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Bukurie Zefi | Qebik | | [signature] |
| 2. | Mirand Zefi | Qebik | | [signature] |
| 3. | Miridon Zefi | Qebik | | [signature] |
| 4. | Mirand Zefi | Qebik | | [signature] |
| 5. | Muharem Dervishaj | Blerim | | [signature] |
| 6. | DHurata Dervishaj | Blerim | | [signature] |
| 7. | RIZA HULI | FLET | | [signature] |
| 8. | BUJAR DERVISHI | BLERIM | | [signature] |
| 9. | BRAHO XHAURI | FLET | | [signature] |
| 10. | ADEM XHAURI | FLET | | [signature] |
| 11. | | | | |
| 12. | | | | |
| 13. | | | | |
| 14. | | | | |

3751/1 prot
dt. 26.11.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa:Fushë-Arrëz,Rruga Qender,email:info@ bashkiafushearrez.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA FUSHË-ARRËZ SEKRETARIA

Fushe-Arrez, me 26.11.2025

# MATERIAL PERMBLEDHES
"Mbi
degjesen publike te dates 26.11.2025, ne Njesine Administrative Iballe, per Dhenie ne Perdorim/Qera te fondit pyjore per energji te rinovueshme (Eolike), Njesia Administrative Iballe, Bashkia Fushe-Arrez".

Po me date 26.11.2025, ora 13.00, ne Njesine Administrative Iballe u zhvillua degjesa publike me banoret e fshaterave te njesise, "Per dhënie ne Përdorim/Qera te fondit pyjore per energji te rinovueshme (Eolike), Njesia Administrative Iballe, Bashkia Fushe-Arrez".

Ne degjese moren pjese; Z.Hil CURRI Kryetar I Bashkise Fushe-Arrez, Z.Akil ZMALAJ, Administrator I Njesise Administrative Iballe, Znj.Fationa SELIMAJ, Drejtoreshe e Zyres Juridike, Prokurimeve Publike dhe Burimeve Njerzore ne Bashkine Fushe-Arrez, Znj.Redona HASANI, Pergjegjese e Zyres Juridike ne Bashkine Fushe-Arrez, Znj.Paola QAFA, Pergjegjese e Zyres se Planifikimit te Territorit ne Bashkine Fushe-Arrez, Z.Aldi LEPURI, Specialist I Zyres Juridike, Zj.Jetmira MURATAJ, Specialiste e Zyres se Planifikimit te Territorit ne Bashkine Fushe-Arrez, Z.Nikolin QAFA, Pergjegjes I Policise Bashkiake.

-Nga Njesia Administrative Iballe, te pranishem ishin personeli I Njesise si dhe banore te Njesise Administrative qe perfshijne pothuajse te gjithe fshaterat si; Iballe, Mertur, Berishe e Eper, Levoshe, Berishe e Vogel, Sapaç, Shopel, Berishe Vendi.

-Degjesa u hap nga Administratori I Njesise Iballe, Z.Akil ZMALAJ, I cili citoi se;

-Puna dhe vemendja e Bashkise, eshte e perqendruar ne drejtim te zhvillimit te Zones, duke ndikuar sado pak si ne rritjen e nivelit ekonomik te komuniteti, por edhe te zhvillimit territorial dhe ne permbushje te programit elektoral.

-Per kete nga ana e Kryetarit te Bashkise, e Stafit te tij si edhe e lobimeve te panderprera me Institucione te shtetit dhe Donator te huaj, jane bere studime, plane zhvillimi dhe sidomos ne drejtim te prodhimit te energjise se rinovueshme (Eolike) dhe asaj fotovoltaike, ku kerkesat dhe interesimet e Sipermarresve jane te medha dhe te vazhdueshme

-Degjesat publike, per projekte te tilla, madhore dhe per nje Vendim marrje sa me te drejte, ligjore dhe te pranuar per palet dhe Komunitetin jane veprim tashme I konsoliduar I kryetarit te Bashkise dhe stafit te tij.

-Njesia Administrative Iballe, ka nje shtrirje te madhe gjeografike, dhe pika shume te lakmuara per zhvillimin e nje industrie te till, por dhe pa cenuar edhe interest e Komunitetit ku shtrihen,

-Duhet theksuar se perpjekia dhe angazhimi I yne ka qene maksimal per te bere me te miren e mundeshme per komunitetit qe perfaqesojme. Per kete nje falenderim I veçante shkon per Kryetarin e Bashkise per vemendjen e shtuar ndaj nesh, per te ngritur zerin ne Institucionet perkatese duke bere me te miren e mundeshme per ne.

***Problemet e ngritura nga Administratori;***

-Ngritja e nje industrie te till, duhet qe mos te cenoje interesat e Komunitetit qe perfaqesojme.

-Te sjelle zhvillimin e zones dhe te rrise nivelin ekonomik te banoreve.

-Te garantoje permiresimin dhe mirembajtjen e Infrastruktures rrugore ne zone.

-Prioritet per punesim ne kete industri te jene banoret e zones.

-Te mos cenojne Floren dhe Faunen e zones.

**-Zj.Tereze DEMA**, anetare e Keshillit Bashkiak te Bashkise Fushe-Arrez, u shpreh se;

-Per projekte madhore dhe qe I sherbejne rritjes se mireqenjes se komunitetit tone, jemi ne mbeshtetje te zbatimit te tyre.

**Z.Hil CURRI, Kryetari I Bashkise Fushe-Arrez, u shpreh;**

-Keto degjesa publike me Komunitetin, jane nje vazhdimesi e punes tone, me qellim qe te marrim mendimet e sugjerimet e Grupeve te Interesit para vendim marrjeve te medha siç jane; Ato te dhenjes se pasurive publike per zhvillimin e zones, ose siç ishte dhe ajo per Buxhetin afat mesem si dhe Buxhetin dhe Paketen Fiskale per vitin 2026, ose siç mund te jete dhenia e pasurive publike per qellime te zhvillimit ten je zone te caktuar.

-Une kam qene, jam dhe do te jem I gatshem dhe I predispozuar per tu sherbyer me te gjitha mundesite qe kam, me po aq dashuri sa keni Ju banoret e Iballes per Njesine Tuaj.

-Gjeje rastin te falenderoi dy anetaret e Keshillit Bashkiak te Njesise Iballe, qe edhe pse me bindje te kunderta, kemi gjetur menyren e komunikimit e

bashkepunimit te perbashket dhe shume korrekt per çdo te mire te realizuar ne Njesine Iballe dhe jo vetem.
-Bashkia Fushe-Arrez, nuk eshte me e varfer, ka pune pa fund, si tek Fabrikat e Ujit, ashtu edhe tek Minjerat, por banoret nuk pranojne te punojne.
-Iballia, ka potenciale te medha Intelektuale dhe Biznesmen te fuqishem dhe qe jane rezultativ ne te gjithe territorin e vendit tone dhe qe duhet te kthehen ne lobues te fuqishem te zones se tyre, pasi Zona eshte nje dhurat e natyres me resurse te jashtezakonshme per zhvillim.
-Nga ana e Bashkise, jane bere studime, plane zhvillimore dhe lobime per Zonen e Gjelber, energjine fotovoltaike dhe ate Eolike, nje Industri kjo mjafte shpresedhenese dhe me afat te gjate ne kohe qe garanton nje zhvillim te qendrueshem te zones dhe qe shkon ne sinkron me prioritet tona, dhe qe jane;
-Zhvillimi I Komunitetit;
-Mos shpopullimi I Zones;
-Kjo do ndodhe ne saj te punes paraprake dhe asaj qe do bejme ne vazhdimesi, si me zhvillimin e territorit nepermjet ndertimit te Impianteve fotovoltaike, atyre Eolike, Hidrocentraleve te vegjel, ku vetem ne territorin e Iballes jane dhene 3 leje, ashtu edhe nepermjet zbatimit te Paketes se Maleve per zhvillimin e pronave, ku ne jemi shume optimist.
-Ndertimi I Impianteve te prodhimit te Energjise Fotovoltaike dhe asaj Eolike, eshte teper me interes, si ne sensing e punesimit, te perfitimeve te Bashkise nga ndertimi I ketyre impianteve ashtu dhe ne zhvillimin ekonomik te Zones.
-Gjithashtu garantoj Administratorin dhe te gjithe Ju, banore te Njesise Administrative Iballe, se te gjithe pretendimet e ngritura ne kete takim, do te jene pjese per zbatim e Kontrates mes Bashkise dhe Sipermarresit per zhvillim te Zones.
Po keshtu te gjithe pjesmarresit ne degjese, ishin dakort me te gjithe sa u shtruan nga Kryetari I Bashkise lidhur me zhvillimin e zones nepermjet vendosjes se impianteve te prodhimit te Energjise Fotovoltaike dhe asaj Eolike, por duke respektuar edhe kerkesat e shtruara nga Administratori I Njesise Administrative Iballe.

Fationa SELIMAJ

Iballe, më 26 . 11 .2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

# LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE MBI PROJEKTVENDIMIN "PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QERA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME (EOLIKE), NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLE, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

| Nr. | Emër Mbiemër | Njësia/Qyteti/Fshati | Pozicioni/Profesioni | Firma |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Naue Hotagjun | 0682536810 | K. Plak | [signature] |
| 2. | Mhill Dedaj | | K. Plak | [signature] |
| 3. | Florjan Vata | | IPA - Pune | [signature] |
| 4. | Agim Ang | | NE | [signature] |
| 5. | Grim Hajdari | | punojës | [signature] |
| 6. | Gjelosh Vukzaj | | Shofer | [signature] |
| 7. | Artrit Lohala | Kryplak Levoshë 0685683628 | Elektricist | [signature] |
| 8. | Gjerasim Hota | | Mesues | [signature] |
| 9. | Pashk Mirashi | | Bonor | [signature] |
| 10. | Ditmir Pershpaj | Kryplak Shoshe 0685555596 | | [signature] |
| 11. | Mirash Marku | | | [signature] |
| 12. | Kristjan Solah | | Ludric | [signature] |
| 13. | Gzim Mhilli | | punonjës nr. rurale | |
| 14. | Fatmir Sulejmani | | Punonjës shkolle | |

Iballe, më 26 . 11 .2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE MBI PROJEKTVENDIMIN "PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QERA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME (EOLIKE), NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLE, BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

| Nr. | Emër Mbiemër | Njësia/Qyteti/Fshati | Pozicioni/Profesioni | Firma |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Tom Marku | | Punonjës shkolle | [signature] |
| 2. | VASIL SUTAJ | | PA PUN | [signature] |
| 3. | Ardit Deda | Iballë | Punoje shoqate | [signature] |
| 4. | XHEVAHIR ALIA | Iballe | — " — | [signature] |
| 5. | Bесo Aga | Iballe | — " " | [signature] |
| 6. | EMIRJAN LAMAJ | | | [signature] |
| 7. | Fatmir Topalli | Iballe | Puntor shkolle | [signature] |
| 8. | Armand Ndoj | Iballe | P. Pyjore | [signature] |
| 9. | Astrit Aga | Iballe | P. Pyjores | [signature] |
| 10. | Viktor Murati | Ibal. | Rruga | [signature] |
| 11. | Pavlu Pjetri | Ibal. | Rruga | [signature] |
| 12. | Alfred Matosi | | | [signature] |
| 13. | Ndoc Pemati | | | [signature] |
| 14. | Isuf Ibraj | | punëtor | [signature] |

15) Ndue Nikoi [signature]

Iballe, më 26 .11 .2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**
**KËSHILLI BASHKIAK**

## LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE MBI PROJEKTVENDIMIN "PËR DHËNIE NË PËRDORIM/QERA FONDIT PYJOR PËR ENERGJI TË RINOVUESHME (EOLIKE), NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLE, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

| Nr. | Emër Mbiemër | Njësia/Qyteti/Fshati | Pozicioni/Profesioni | Firma |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Angjelin Deda | Iballë | banor | |
| 2. | Gëzo Zef | | banor | |
| 3. | Pashk Ndoka | | banor | |
| 4. | Tereze Dema | | Mësuese | |
| 5. | Aldi Lepuri | | Jurist | [illegible] |
| 6. | Jetmira Muratsj | | Inxhiniere | [illegible] |
| 7. | Redona Haseri | | Juriste | [illegible] |
| 8. | Fationa Selimaj | | Juriste | [illegible] |
| 9. | | | | |
| 10. | | | | |
| 11. | | | | |
| 12. | | | | |
| 13. | | | | |
| 14. | | | | |